

FASTIP, fakulteti që i nevojitet sipërmarrjes



Nikolin JAKA

Kryetar i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë, Tiranë

ditë ua përcjell dhe njerëzve të shumtë që takoj, qofshin këta sipërmarrës vendas, qofshin sipërmarrës të huaj që duan apo ushtrojnë aktivitetin e tyre në vendin tonë. Në këto 20 vite ekonomi tregu të hapur të vendit tonë, në plan të parë dhe ajo çfarë mbetet më e rëndësishme është pasja

FASTIP-I është fakulteti i vetëm në Shqipëri ku integrohen në raporte të barabarta studimet akademike me trajnimin praktik në vendin e punës. Parë në këtë dritë ndjehem i nderuar që jam pjesë e Këshillit të këtij fakulteti. E megjithatë përtej kësaj shoh ndjenjën e përgjegjësisë që bie mbi mua si një ndër përfaqësuesit e biznesit për të bërë të mundur integrimin e studentëve që dalin nga këto banka, me biznesin që më shumë se për çdo gjë tjetër ka nevojë për burime njerëzore të kualifikuara. Këtë fakt e kam parë si një sfidë personale timen dhe që nga dita në

e kapaciteteve njerëzore të kualifikuara me kërkesat e tregut. Profesionalizmi në fusha të caktuara është tashmë çelësi i suksesit për sipërmarrësit. Nëse në fillimet e biznesit të tyre shumë shqiptarë ecën me instiktin dhe guximin e tyre, sot nuk mund ta bëjnë më. Të dalësh hapur në një ekonomi globale do të thotë se përveç këtyre dy faktorëve është kualiteti njerëzor që të ofron sukses dhe siguri në treg. FASTIP-i e ka kuptuar këtë gjë dhe po u jep drejtimin e duhur studentëve të tij, duke i integruar me sipërmarrjen që tashmë po fiton pjekurinë e duhur në treg. U ndjeva krenar që në iniciativën e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë, Tiranë, në shtator të vitit të kaluar, në organizimin e panairit Work&Study, FASTIP-i u bë pjesë e kësaj sipërmarrje. Në gjithë ditët e këtij panairi ajo që konstatova me kënaqësi ishte serioziteti i stafit të FASTIP-it për të sjellë më të mirën e tij në evidentimin e potencialit që po krijon kjo nismë. Uroj që të jemi në një rrugë të gjatë bashkë dhe të mund të sjellim për studentët dhe sipërmarrësit më të mirën dhe më të sigurtën në tregun shqiptar, atë për të cilën realisht ka nevojë ky vend, të kualifikohen këtu pa patur nevojë të kërkojnë diku jashtë kufinjve. Jam i bindur që kjo ide po përforcohet çdo ditë dhe po merr tonet e duhura.

Kampusi Universitar i UAMD

Bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave, Nr. 213, Datë 16.03.2011, Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, do të fillojë ndërtimin e një kampusi të ri universitar bashkëkohor i cili do të mund të reflektojë historinë, kulturën dhe imazhin e këtij universiteti.

Kampusi, i cili do të konsiderohet si një qytezë e vogël, do të ngrihet mbi një sipërfaqe prej 54 ha tokë dhe do të shërbejë për akomodimin e rreth 20.000 studentëve, të personelit akademik e administrativ.

Në funksion të këtij projekti, më datë 08.04.2011, ora 9:30, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor Durrës, ndërmorri nismën e mbjelljes së 500 fidanëve pishe pranë zonës së Spitalllës, mbi të cilën do të ngrihet dhe Kampusi i ri Universitar.

Të pranishëm në këtë aktivitet ishin Ministri i Arsimit dhe Shkencës Z. Myqerem Tafaj, Rektori i Universitetit “Aleksandër Moisiu” Prof. As. Dr. Mit’hat Mema, Z. Ferdinand Xhaferaj, Z. Seid Kërtusha, staf akademik dhe administrativ, studentë të Universitetit si dhe përfaqësues të medias.



Marrëveshje bashkëpunimi Kompani Trajnuese-Student

****Kjo marrëveshje është model. Kjo do të thotë se studentët apo kompanitë mund të vendosin mes tyre kushte apo detyrime të tjera, të përshtatshme për të dyja palët.*

Kontratë sponsorizimi dhe trajnimi për studime në Fakultetin e Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP) pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu" të Durrësit, që përfundon me diplomën Universitare Bachelor në "Menaxhim"

Sot me datë/...../2011, në selinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Firmës trajnuese, u lidh kjo kontratë, mes palëve dhe me kushtet e mëposhtëme:

Kompania sponsorizuese dhe trajnuese: e përfaqësuar nga Drejtori i përgjithshëm Z./Znj. që më poshtë do të quhet „Kompani trajnuese“ dhe studentit/studentes Z./Znj. lindur më: në Kombësia, Tel, Banues në adresën, madhor/e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, këtu e më poshtë e quajtur “studenti”

A. Objekti

Objekt i kësaj kontrate është trajnimi praktik i studentëve në Kompaninë trajnuese në bazë të kushteve të rëna dakord si më poshtë për diplomën universitare **Bachelor** në degën Menaxhim sipas planit të studimeve të **Fakultetit të "Studimeve të Integruara me Praktikën"** (FASTIP) pranë Universitetit “Aleksander Mosiu” Durrës.

B. Kohëzgjatja e studimeve

Studimi për marrjen e diplomës universitare Bachelor zgjat tre vjet. Ai fillon më dhe përfundon më.....

Fazat e trajnimit praktik realizohen në njesitë organizative të Firmës trajnuese.

Caktimi i vendeve të trajnimit bëhet në marrëveshje me universitetin dhe në përputhje me planin e studimeve, si dhe u njoftohet në kohë studentëve nga ana e kompanisë trajnuese. Për aktivitetet trajnuese, që kryhen jashtë kompanive trajnuese, hartohet një plan zbatimi individual.

C. Koha javore e trajnimit

Koha e rregullt javore e punës në kompaninë trajnuese është 40 orë. Koha e trajnimit zgjatet nëse nuk mund të jepen provimet brenda afatëve të parashikuara. Koha e provës është 3 muajt e parë të kohës së trajnimit në firmat trajnuese.

D. Koha e pushimeve

Studentja/studenti ka të drejtën e pushimit për 20 ditë pune në vit ose 4 javë kalendarike.

E. Të drejtat dhe detyrimet e palëve

Firma trajnuese do të mbështesë financiarisht studentin/ studentën, për të gjithë periudhën e studimit dhe trajnimit. Financimi do të jetë në shumën Euro në muaj për kohëzgjatjen e kontratës.

Firma trajnuese detyrohet të respektojë parimet e përshtatshmërisë së firmave trajnuese.

Firma trajnuese detyrohet të trajnojë me kujdes studentët, sipas planeve të praktikës, për të cilat është rënë dakord me partnerin dual: Fakultetin e Studimeve të Integruara me Praktikën, UAMD.

Studenti/ Studentja detyrohet të frekuentojë rregullisht leksionet e ofruara dhe të japin rregullisht provimet.

Student / Studentja detyrohet të frekuentojë programin e trajnimit praktikës të miratuar nga FASTIP.

Anullimet e kontratës mund të bëhen vetëm gjatë kohës së provës ose për shkaqe bindëse.

Në fund të marrëdhënieve kontraktuale, Kompania trajnuese i lëshon studentes/studentit një dëshmi.

F. Dispozita të veçanta.

1. Nëse student/studentja largohet para mbarimit të studimeve dhe të trajnimit, ai /ajo detyrohet të rimbursojë Kompaninë trajnuese në shumat e financuara nga kjo e fundit, për shpenzimet e paguara vetëm për patneritet në FASTIP për student (..... Euro viti).

2. Kompania trajnuese gëzon të drejtën e punësimit selektiv në bazë të vlerësimit të performancës së studentit/ studentes gjatë viteve të studimit në FASTIP në momentin e diplomimit.

3. Studenti i përzgjedhur për punësim në Kompaninë Trajnuese, duhet të punojë jo më pak se 3-vjet në këtë firmë. Në rast të ndërprerjes së kontratës së punës nga Studenti /Studentja, firma ka të drejtë të kërkojë rimbursimin e shumës prej Euro në vit (shpenzimet e paguara për patneritet në FASTIP) për pjesën e pakonsumuar të kontratës 3-vjeçare të punës.

4. Kompania trajnuese nuk mban përgjegjësi në rast të ndërprerjes së projektit FASTIP nga UAMD.



Marrëveshjet në faqen e dytë janë objekt i kësaj kontrate dhe njihen si të tilla. Kontrata hartohet në tre kopje të njëjta dhe nënshkruhet nga vetë palët kontraktuese.

Kompania trajnuese

Studentja/studenti

Drejtor i Përgjithshëm

(Emër, Mbiemër; Firmë)



Marrëveshje bashkëpunimi FASTIP– Kompani Trajnuese



Midis kompanisë trajnuese dhe Fakultetit të Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP) mbyllet kjo marrëveshje për trajnimin që përfundon me diplomën universitare Bachelor, në kursin Menaxhim i sipas planit të studimeve të FASTIP:

Përgjegjësitë:

Përgjegjësi/Përgjegjësj

për trajnimin e studentëve në Kompaninë e sipërpërmendur është:

Emri:

Telefoni:

Adresa e-mail:

Afati i marrëveshjes:

Marrëveshja është e vlefshme për periudhën nga deri

por në çdo rast deri në përfundimin e të gjithë trajnimit të studentëve të punësuar në Kompani për këtë studim.. Kjo marrëveshje hyn në fuqi pas ratifikimit nga Këshilli i Fakultetit.

Numri i vendeve të trajnimit të vëna në dispozicion:

Kompania vë në dispozicion vende trajnimi praktik për fillimin e studimeve për vitin akademik 20xx-20xx.

Kompania është përgjegjëse për numrin e vendeve të trajnimit praktik të vëna në dispozicion dhe është dakord që FASTIP t'u japë aplikantëve të interesuar një listë të këtyre vendeve.

Detyrimet e studentëve:

Studentët janë të detyruar të frekuentojnë rregullisht leksionet e ofruara dhe të japin rregullisht provimet.

Detyrimet e Kompanisë trajnuese:

Kompania trajnuese është e detyruar të respektojë parimet e përshtatshmerine e Kompanive trajnuese.

Kompania trajnuese është e detyruar të trajnojë me kujdes studentet sipas planeve të praktikës, për të cilat është rënë dakord me partnerin dual.

Kompania trajnuese kontribuon për financimin e fazave të teorise. Kontributi vendoset në miratim me Këshillin e FASTIP-it. Ky kontribut pëvitin akademik vitin akademik 20xx-20xx është Euro në vit për student.

Kompania trajnuese merr përsipër të gjitha shpenzimet e trajnimit praktik të studentëve të saj. Në këtë rast Kompania mund të bjerë dakord me studentin për një shpërblim trajnimi. Të tjerat rregullohen në kontratën e trajnimit midis Kompanisë trajnuese dhe studentit.

Brënda mundësive të saj, Kompania trajnuese ndihmon dhe me ekspertë të saj për dhënien mësim si pedagogë të jashtëm në FASTIP të leksioneve speciale të lidhura me praktikën.

Sipas mundësive, Kompania e trajnimit merr pjesë në provimet e praktikës.

Marrëveshja bëhet në tri kopje të barazvlefshme dhe nënshkruhet nga palët e kontratës.

Marrëveshja ka efekte ligjore vetëm nëse Kompania ka punësuar studentë për të studiuar në FASTIP dhe këta janë miratuar nga FASTIP-i për të vazhduar studimet.

Durrës, më

Kompania trajnuese

FASTIP



(vula/ firma)

(vula/ firma)

.....

.....

Deri tani FASTIP mbështetet nga:



Kurrikula e Menaxhimit të Ndërmarrjeve të Vogla dhe Mesme

Viti	Sem	Lloji*	Kodi	Kursi	Kursi i parakerkuar	ECTS
I	I	D	LANG 151	Shkrim Akademik dhe Metodatat e Kerkimit Shkencor		4
		D	ECON 163	Mikroekonomi		5
		D	MANG 118	Komunikim Ndermarrje		3
		D	MANG 178	Bazat e Biznesit		5
		D	LAËS 170	E Drejta Publike dhe Civile		4
		D	FINC 192	Hyrje ne Finance		4
			PRAC 127	Praktike		4
	II	D	MARK 288	Bazat e Marketingut		4
		D	MATH 225	Matematike		4
		D	MANG 365	Sjellje Organizative		3
		D	FINC 298	Bazat e Kontabilitetit		5
		D	FINC 327	Analiza e Kosos		5
		D	MANG 244	Drejtim Nderkulturor		4
			PRAC 187	Praktike + Detyre Kursi		6
II	III	D	FINC 236	Kontabiliteti Financiar	Bazat e Kontabilitetit	5
		D	LAWS 238	E Drejta Tregtare dhe e Punes	E Drejta Publike dhe Civile	4
		D	FINC 253	Plan Biznesi, Investimi dhe Financimi	Hyrje ne Finance	4
		D	MANG 251	Drejtimi i Shitjeve	Bazat e Biznesit	5
		D	COSC 267	Bazat e Teknologjise se Informacionit		4
		Z	LANG 252	Gjermanisht 1		3
			SOCL 260	Sociologji		
		MANG 257	Drejtim Mjedisi			
		PRAC 227	Praktike		4	
	IV	D	MANG 325	Drejtim dhe Organizim Projekti	Bazat e Biznesit	5
		D	ECON 192	Makroekonomi	Mikroekonomi	5
		D	MANG 268	Drejtimi i Burimeve Njerezore		4
		D	MATH 325	Statistike	Matematike	4
		D	MANG 337	Logjistike dhe Shperndarje		4
Z		LANG 292	Gjermanisht 2	Gjermanisht 1	3	
		MARK 321	Marketing Konsumatori	Bazat e Marketingut		
	HIST 351	Histori Ekonomike				
	PRAC 287	Praktike + Detyre Kursi		6		
III	V	D	MANG 421	Drejtim dhe Udheheqje		5
		D	ECON 381	Analize Tregu dhe Konkurrenca		4
		D	FINC 412	Fiskaliteti		4
		D	FINC 422	Kontabilitet per SME-te	Bazat e Kontabilitetit	4
		D	ECON 455	Politika Ekonomike	Makroekonomi	5
		Z	LANG 352	Gjermanisht 3	Gjermanisht 2	3
			MANG 408	Sipermarrja		
		MANG 409	Drejtimi i Marredhenieve me Klientin			
		PRAC 327	Praktike		4	
	VI	D	MANG 452	Drejtim Strategjik	Drejtim Projekti	4
		D	MANG 459	Drejtimi i Furnizimit te Zinxhirit Global	Logjistike dhe Shperndarje	4
		D	MANG 463	Drejtimi i Prodhimit dhe Cilesise		4
		D	ECON 465	Ekonomi Nderkombetare		4
		D	MARK 447	Marketing per SME-te	Bazat e Marketingut	4
Z		LANG 392	Gjermanisht 4	Gjermanisht 3	3	
		MANG 439	Vendimmarrje	Drejtim dhe Udheheqje		
	MANG 441	Sjellje e Konsumatorit				
	PRAC 387	Praktike + Teme Diplome		8		

Buletini Informativ i FASTIP-it përmbledh informacionet më të rëndësishme si dhe mendime e përshtypje rreth fakultetit.

Ky Buletin Informativ del çdo 4 muaj.

Përgatiti: Anduela Kaja

Redaktoi: Denata Nuellari

Kontakte:

Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën
 Lagjja 17 Rruga "Adria" Durrës-Shqipëri
 Tel+Fax: +355-52-22 44 16
 Email: info@fastip.edu.al
 web: www.fastip.edu.al